



KRM "PASTËRTIA" SH.A. FERIZAJ

Rr. "Enver Topalli" Nr. 47 Tel. 0290/325-025

Kryeshefi Ekzekutiv i KRM "Pastërtia" Sh.A.Ferizaj bazuar në Nenet 8, 10 paragrafi 2.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-121, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik dhe Nenin 16 të Statutit të Kompanisë shpall:

K O N K U R S

Për vende të punës:

Nr. i referencës se pozitive të punës:

- | | |
|-------------------------|-----------------|
| - Dy (2) Inkasant | Nr. 1-1235/2020 |
| - Dy (2) Punëtorë Fizik | Nr. 2-1235/2020 |

Përgjegjësi mbikqyrëse: Jo

Raportimi: Udhëheqësve të lëmvive përkatës

Orari i plotë i punës: Po

Kohëzgjatja e emërimit, Periudha e punës 1 vjeçare me mundësi vazhdimi

Koeficientet: Në harmoni me politikat zhvillimore të Kompanisë

Vendi i punës: Ferizaj, Kaçanik

Dokumentet e nevojshme:

- Aplikacionin për punsim;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshminë që nuk është nën hetime, jo më të vjetër se 3 muaj.

Përshkrimi i vendit të punës dhe përvoja e punës:

Inkasant:

Bënë inkasimin e mjeteve në bazë të faturave me të cilat ngarkohet materialisht, bënë zbulimin-regjistrimin me kohë të sipërfaqeve të reja dhe të paregjistruara dhe përcjell ndryshimet apo ndërrimet e sipërfaqeve dhe ndryshimet tjera të nevojshme në sektorin e amvisëris respektivisht komercial duke e nojftuar Shërbimin e faturimit.

Kualifikimi: Diplomën e Shkollës së Mesme.

Punëtor Fizik:

Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave, është përgjegjës për përdorimin e kujdesshëm të kantonierëve, zbrazen e tyre dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre, respekton orarin e punës pastron rrugët, trotuarët dhe sipërfaqet tjera, bënë zbrazen e shportave, në sezonën e dimrit bënë pastrimin e rrugëve nga bora dhe akulli, shpërndarjen e kripës.

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, të kenë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Aplikacioni mund të merret në zyret e KRM "Pastërtia" Sh.A. Ferizaj, Rr."Enver Topalli" Nr.47 Ferizaj, ku edhe bëhet dorëzimi i Aplikacionit së bashku me dokumantacionin e kërkuar në zarf të mbyllur, apo mund të shkarkohet edhe në web-faqen e Kompanisë: www.pastertia.com.

Afati i konkursit për aplikim është i hapur 15 ditë kalendarik nga dita e publikimit në web-faqen e Kompanisë si dhe në shtypin ditor, duke filluar nga data **12.06.2020 deri më 30.06.2020 në orën 16:00.**

Për informata shtesë mund të kontaktoni numrin e tel. 0290/325-025.